

Dalës-Izlazna

Nr. -1-340
Br.

Data 30.10.2020
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008),nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së OVL-së të UÇK-së, nr.-I-23632, e dt.19.10.2020, në mbledhjen e mbajtur me dt.29/30.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

1. Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.-I-68, të dt.25.04.2019, i Komisionit për për zgjedhjen e përfituesve të së drejtës në banim për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së, familjeve të dëshmorëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale dhe personave tjerë me nevoja të veçanta, ashtu që në vend të anëtarit Imer Grajqevci, caktohet anëtari Fehmi Mjeku.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'idërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesuesit
- MPL-së
- Anëtarëve të Komisionit
- Anëtarëve të KK-së
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Qëllim:

Nr. 1-68
Nr.

Data 25.04.2019
Data



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr 07/96 ,dt.02.04.2019 , pika 3 e vendimit , Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.18.4.2019, mori këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni për përzgjedhjen e përfitueseve të së drejtës në banim , për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së , familje të dëshmorëve , veteranëve , viktimave të dhunës seksuale dhe përsoneve tjerë me nevoja të veçanta nga këtë kategori .
2. Komisioni sipas pikës (1) të këtij vendimi përbëhet prej shtatë (7) anëtar
 - 2.1. Ibush Mjekiqi ,Nënkryetar Komune dhe u.d.DSHMS, Kryesues i Komisionit
 - 2.2. Fatmir Bektashi ,anëtar i Kuvendit Komunal,
 - 2.3. Labinot Mirena , anëtar i Kuvendit Komunal
 - 2.4. Zelushë Kelemendi, Qendra Rinore –Obiliq
 - 2.5 .Përfaqësues i familjeve të Dëshmoreve SHFD/Obiliq
 - 2.6 .Përfaqësues i Shoqatës së Veteranëve , OVL-UÇK-së /Obiliq
 - 2.7 .Përfaqësues i Shoqatës së Invalideve ,SHIL-UÇK-së /Obiliq
3. Në komision , pjesëmarrës do të jetë edhe një përfaqësues në cilësinë e vëzhguesit nga shoqëria civile .
4. E drejta në banim për përfituesit nga kjo kategori bëhet në Kompleksin kolektiv banesor afarist “ HADE dhe HADE 2 “ për banorët e Komunës së Obiliqit
5. Në kompleksin kolektiv , pesdhjetë (50 %) të njësisve banesore destinohet për qëllim të zgjedhjes së banimit për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së , familje të dëshmorëve , veteranëve , viktimave të dhunës seksuale dhe përsoneve tjerë me nevoja të veçanta nga këtë kategori .
6. Komisioni për përzgjedhjen e përfitueseve të së drejtës së banim për kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së , familje të dëshmorëve , veteranëve , viktimave të dhunës seksuale dhe përsoneve tjerë me nevoja të veçanta nga këtë kategori , vendos në bazë të procedurave të parapara me Ligjin Nr 03/L-164, për financimin e programeve të veçanta të banimit .




Udhëzimi Administrativ Nr21/2010, për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategorit e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Udhëzimi Administrativ Nr 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta për banim , Udhëzimi Administrativ Nr 23/2010 për procedurat e shpalljes së programeve të veçanta të banimit , Udhëzimi Administrativ Nr 24/2010 për normat minimale të banimit për banesat nga programet nga programet e veçanta të banimit të nxjerra në bazë të këtij Ligji si dhe Udhëzimit Administrativ Nr 14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve , të zhdukurëve të UÇK-së , për Veteranët e UÇK-së , invalidët civil të luftës , viktimat seksuale të luftës dhe familjarëve të tyre .

7. Komisioni në takmin e pare do të vendos për metodologjinë e punës për të gjithë procesin e përzgjedhjes për përfituesit e të drejtës në banim .
8. Komisioni, vlerësimin e gjendjes në banimit në teren , të familjeve si dhe verifikimin e të dhënave të kërkueseve e bënë në afat prej tridhjetë (30) ditësh .
9. Pas vlerësimit të gjendjes së banimit nga terreni i familjeve nga ana e Komisionit , Komuna publikon listën e familjeve të renditura sipas pikëve të fitura gjatë vlerësimit .
10. Mandati i komisionit zgjat deri në dhënien në shfrytëzim të njësive banesore për përfituesit të së drejtës në banim sipas pikës (5) të këtij vendimi.
11. Komisioni për punën e vet i përgjigjet dhe i raporton Kuvendit Komunal
12. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

T'i dërgohet



- Kryetarit
- Kryesuesit
- Nënkryetarit
- MAPL
- Anëtarëve të Komisionit
- Anëtarëve të KK
- Arkivit



ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS



DEGA NE OBILIQ

				REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA											
				KOMUNA E OBILIQIT-OPŠTINA OBILIC											
				DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME											
				UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE											
Pranuar/Prillogjetur:								19.10.2020							
Nr. organizativo				Nr.				Shtojcë.				Vlerë:			
Organi III				Br.				Prilog:				Vrednost:			
-1-				23632											

Lënda: KERKESE

Për: KUVENDI KOMUNAL – OBILIQ


Komisionin Komunal për ndarje të banesave “Hade”

Pas dorheqjes së anëtarit të OVL të UÇK-së dega në Obiliq z.Imer Grajçevci nga komisioni komunal për ndarje të banesave “Hade”, kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.09.10.2020 vendosi që nga ana jonë të caktohet z.Fehmi Mjeku.

Lusim organet kompetente që të evidentojnë ndryshimin e kërkuar.

Obiliq
Dt.19.10.2020

Kryetari, Fehmi Mjeku

Për

NAZMI SMAILI